



Bazuar në nenin 35 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4 paragrafi 3 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 38 / 24 dhjetor 2015), dhe nenin 42 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2016, miratoi:

RREGULLORE PËR SHITJEN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA DHE MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE TË SIGURUESVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyra e shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, dhe kufizimet e shpenzimeve të menaxhimit të Siguruesve.
2. Kjo Rregullore do të zbatohet për të gjithë Siguruesit e licencuar nga BQK-ja që operojnë në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizime

Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet dhe nenin 2 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Neni 3

Komisionet dhe shpenzimet për ndërmjetësuesit

1. Siguruesit, mund të aplikojnë komision (përfshirë të gjitha shpenzimet tjera) për ndërmjetësuesit në sigurime sa i përket produktit të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, deri në maksimum 10% të shitjes së tij. Në çdo rast komisionet dhe shpenzimet e pikave të shitjes të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia nuk duhet të kalojnë 12% të primit të paguar pas zbritjes së TVSH-së.

2. Në rastet e kthimit dhe anulimit të policave duhet të kthehet edhe komisioni i paguar për pjesën e mbetur të policës.
3. Pagesa e komisioneve të ndërmjetësuesve për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia duhet të bëhet në fund të çdo muaji, bazuar në shitjet e tij. Transferimi i pagesës së komisioneve dhe shpenzimeve të ndërmjetësuesve për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, të parapara me nenin 3 të kësaj rregulloreje duhet të bëhet vetëm me transfer bankar, nga llogaria bankare e dedikuar për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, të përcaktuar me nenin 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Mbajtja e mjeteve në llogari bankare

1. Secili Sigurues është i obliguar të mbajë vetëm një llogari bankare, në të cilën do të grumbullojë mjetet e arkëtuara nga shitja e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia.
2. Nga primi i shitur i sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, në llogarinë nga paragrafi 1 i këtij neni, Siguruesit janë të obliguar të mbajnë minimum 65% të mjeteve në këtë llogari dhe e cila do të përdoret vetëm për pagesën e dëmeve, përfshirë Fondin e Kompensimit dhe komisioneve për ndërmjetësuesit. Pjesa tjetër prej maksimum 35% mund të transferohet në llogari tjera të Siguruesit për mbulimin e shpenzimeve operative të saj.
3. Në rast se fondet e mbajtura në llogarinë e lartpërmendur nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e pagesës së dëmeve dhe Fondit të Kompensimit, në afatin e duhur kohor, atëherë Siguruesi duhet të plotësojë këtë llogari me mjete të lira shtesë nga llogaritë tjera të tij.
4. Përpos pagesës së dëmeve, Fondit të Kompensimit, pagesës së komisioneve të ndërmjetësuesve dhe pjesës për shpenzime operative, llogaria nga paragrafi 1 i këtij neni nuk guxon në asnjë mënyrë të debitohet për qëllime tjera pa aprovimin paraprak të BQK-së (për qëllime tjera nënkupton të gjitha investimet, të përcaktuara me Rregulloren e aseteve për mbulimin e provizioneve teknike).

Neni 5

Raportimi i Siguruesve dhe ndërmjetësuesve në BQK

1. Secili Sigurues, në baza mujore, është i obliguar që deri me datë 5 të muajit vijues, të dorëzojë në mënyrë elektronike në BQK informatat si më poshtë:
 - a) Llogarinë bankare të shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për muajin paraprak;
 - b) Raportin e detajuar të pagesës së dëmeve nga llogaria bankare e shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia;
 - c) Raportin e detajuar të shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, me llogaritjen e komisionit dhe shpenzimeve nga neni 3 i kësaj rregulloreje.

Neni 6

Menaxhimi i shpenzimeve të përgjithshme dhe parapagimeve

1. Siguruesit, mund të bëjnë shpenzime të përgjithshme në para të gatshme, deri në maksimum 35% të totalit të primit të pranuar në para të gatshme, nga të gjitha klasat e sigurimeve. Kufizimi prej 35% do të llogaritet në këto shpenzime:
 - a) Shpenzimet e komisionit të ndërmjetësuesve,
 - b) Shpenzimet e përfaqësimit, reklamës dhe promocionit
 - c) Shpenzimet e qerasë të zyrave, përveç të shitjes nga sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia,
 - d) Shpenzimet e pagave (përveç të ndërmjetësuesve dhe të çdo personi që është i afërt me ndërmjetësuesin që lidhen me martesë ose afërsi të gjakut deri në shkallë të dytë) mëditjeve dhe shpenzimet tjera të ndërlidhura me stafin,
 - e) Shpenzimet e sponsorizimeve
 - f) Shpenzimet komunale (energji elektrike, uji, mbeturinat dhe të ngjashme)
 - g) Shpenzime tjera të paguara në para të gatshme
2. Kufizimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni përlllogaritet mbi bazën e të hyrave e pranuar në para të gatshme nga primet e shkruara bruto dhe pagesën e shpenzimeve të paguara në para të gatshme.
3. Siguruesit mund të bëjnë shpenzime të përfaqësimit, reklamës dhe promocionit ekonomik deri në maksimum 3% të primit të shkruar bruto të arkëtuar nga shitja e të gjitha klasave të sigurimit.
4. Shpenzime të reklamës dhe promocionit konsiderohen shpenzimet të cilat bëhen përmes formave të ndryshme të informimit, siç janë: televizioni, radio, gazeta, revista, reklama e drejtpërdrejtë, interneti, posterat, afishet, billboardat, reklamata tranzite e të tjera të ngjashme.
5. Shpenzimet për reklama/marketing do të njihen si të tilla dhe mund të kapitalizohen vetëm në rast se i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Kur shpenzimet për reklama kanë për qëllim primar gjenerimin e shitjes nga policëmbajtësit, përmes të cilëve mund të tregohet se i janë përgjigjur qëllimit të reklamës në mënyrë specifike.
 - b) Siguruesi duhet të jetë në gjendje të dokumentojë relacionin ndërmjet shpenzimeve për reklama dhe të hyrave nga shitja e produkteve të sigurimeve, duke specifikuar emrin e policëmbajtësit dhe reklamën që shkaktoi shitjen e produktit.
6. Kur aktiviteti i reklamës rezulton në të hyra të pritshme në të ardhmen të cilat tejkalojnë kostot e pritshme në të ardhmen për të realizuar të hyra nga shitja, Siguruesi duhet të jetë në gjendje të demonstrojë korrelacionin ndërmjet produktit apo shërbimit dhe shpenzimeve të marketingut duke u bazuar në të dhëna dhe modele historike të verifikueshme.
7. Siguruesit në asnjë mënyrë nuk duhet të lejojnë paradhënie ndaj ndërmjetësuesve të sigurimeve, apo dikujt tjetër.

Neni 7

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

1. BQK-ja mund të shqiptojë, proporcionalisht me shkeljet, masa administrative ndaj një siguruesi, i cili nuk zbaton në përpikëri kërkesat e kësaj Rregulloreje.
1. Në rast se ekzaminimet e BQK-së konstatojnë shkelje të nenit 3 të kësaj Rregulloreje apo tejkallim, në çfarëdo mënyre, të komisionit për ndërmjetësuesit prej 10% dhe me shpenzime prej 12%, BQK-ja mund të zbatojë masat e përcaktuara me nenin 124 paragrafët 1 dhe 2, nënparagrafin 2.3 “ndalon lëshimin e policave të reja të sigurimit apo ndalon përtëritjen e policave ekzistuese” dhe nënparagrafi 2.4 “cakton kufizime në aktivitet” dhe nenin 126 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 “i kërkon siguruesit, ndërmjetësuesit apo trajtuesit të dëmeve në sigurime të shkarkojë personin e caktuar nga posti i tij”.
2. Në rast të përsëritjes së shkeljes së ngjashme, të nenit 3 të kësaj rregulloreje, BQK-ja mund të marrë masa shtesë të parapara me nenet 124, 125 dhe 126 të Ligjit për Sigurimet;
3. Në rast se ekzaminimet e BQK-së konstatojnë shkelje të nenit 4 të kësaj Rregulloreje, apo nuk zbatohen kërkesat e përcaktuara me këtë nen, BQK-ja përveç masave nga nenet 124, 125 dhe 126 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet, mund të ndërmarr masat si në vijim:
 - a) Në rastin e shkeljes për herë të parë, shqipton gjobë për kompaninë deri në 15,000 euro, gjobë për kryeshefin ekzekutiv në shumë prej 1,500 euro dhe urdhëron kthimin e menjëhershëm të mjeteve;
 - b) Në rastin e shkeljes për herë të dytë, shqipton gjobë deri në 30,000 euro, gjobë për kryeshefin ekzekutiv në shumë prej 3,000 euro dhe urdhëron kthimin e menjëhershëm të mjeteve;
 - c) Në rastin e shkeljes për herë të tretë, shqipton gjobë deri në 50,000 euro, urdhëron kthimin e menjëhershëm të mjeteve si dhe mund të zbatojë nenin 126 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 “i kërkon siguruesit, ndërmjetësuesit apo trajtuesit të dëmeve në sigurime të shkarkojë personin e caktuar nga posti i tij”.
4. Në rast të mos zbatimit të kërkesave për raportim sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje, BQK-ja përveç masave nga nenet 124, 125 dhe 126 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet, mund të ndërmarr masat si në vijim:
 - a) Do të shqiptojë gjobë në vlerë prej 200 euro për çdo ditë vonese për raportim;
 - b) Në rast se vonesa përsëritet për periudhën e raportimit për herë të dytë, do të shqiptohet gjobë në vlerë prej 350 euro për çdo ditë vonese;
 - c) Në rast se vonesa përsëritet për periudhën e raportimi për herë të tretë, do të shqiptohet gjobë në vlerë prej 500 euro për çdo ditë vonese.
 - d) Në rast të vonesave të vazhdueshme edhe pas herës së tretë, do të merren masa në pajtim me nenin 126 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 “i kërkon siguruesit,

ndërmjetësuesit apo trajtuesit të dëmeve në sigurime të shkarkojë personin e caktuar nga posti i tij” të Ligjit për Sigurimet.

5. Në rast të mos zbatimit të kërkesave të nenit 6 të kësaj Rregulloreje, BQK-ja përveç masave nga nenet 124, 125 dhe 126 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet, mund të ndërmarr masat si në vijim:
 - a) Në rast se ekzaminimet dhe analizat e BQK-së evidentojnë tejkalim të limiteve të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Rregulloreje, kompanisë mund t’i shqiptohet gjobë në vlerë deri në 25,000 euro si dhe kryeshefit ekzekutiv gjoba prej 2,500 euro.
 - b) Në rast të përsëritjes së shkeljes, BQK-ja mund të shqiptoj gjoba për kompaninë deri në 50,000 euro, si dhe mund të marrë masa të parapara me nenin 126 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 “i kërkon siguruesit, ndërmjetësuesit apo trajtuesit të dëmeve në sigurime të shkarkojë personin e caktuar nga posti i tij” të Ligjit për Sigurimet.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me 4 janar 2017.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci